

**V E N D I M**  
**Nr.8, datë 26.4.1996**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

|                  |                                |     |
|------------------|--------------------------------|-----|
| Rustem Gjata,    | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |     |
| Hilmi Dakli,     | Anëtar i“““                    |     |
| Manol Konomi,    | Anëtar i                       | “““ |
| Veli Budo,       | Anëtar i                       | “““ |
| Franc Jakova,    | Anëtar i                       | “““ |
| Zija Vuci,       | Anëtar i“““                    |     |
| Alfred Karamuço, | Anëtar i                       | “““ |

me sekretare Drita Filto, në datën 7.3.1996, 15.3.1996, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr. 10 Akti, që i përket :

**K E R K U E S E :** BEDRIJE VELI DARDHA, e përfaqësuar nga Av. Kleanth Koçi.

**SUBJEKT I INTERESUAR:** BASHKIA E TIRANES, e përfaqësuar nga kryetari Sali Kelmendi.

**O B J E K T I**

Deklarimin antikushtetues të Urdhërit Nr.1216, datë 26.1.1996 të kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

**V E R E N :**

Kryetari i Bashkisë së qytetit të Tiranës, ka nxjerrë urdhërin administrativ

nr.170, datë 8.1.1996, me anën e të cilit urdhërohej lirimi i një bodrumi në Rrugën “Mine Peza”, marrë me qira dhe adoptuar në lokal tregtie (kafe) nga Bedrije Veli Dardha qysh në vitin 1992. Në datën 9.1.1996, në zbatim të këtij urdhëri, përfaqësues të Bashkisë, të njësishë administrative Nr.3, të ndërmarrjes komunale banesa e të komisariatit të policisë nr.3, kanë mbyllur lokalin.

Kundër urdhërit administrativ, kërkuesja Bedrije Dardha ka ngritur padi në gjykatën e rrethit të Tiranës, duke kërkuar anulimin e tij.

Gjatë kryerjes së veprimeve përgatitore për shqyrtimin e padisë, gjyqtari i çështjes, në zbatim të nenit 128 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur si masë provizore, me vendimin nr.1511, datë 23.1.1996, çbllokimin e lokalit “Kafe Dardha”, pezullimin e ekzekutimit të urdhërit administrativ deri në marrjen e një vendimi tjetër të ndërmjetëm ose përfundimtar nga gjykata. Ky vendim i është

kommunikuar Bashkisë së Tiranës nga Zyra e Përmbarrimit me shkresën nr.366, datë 23.1.1996, ku urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të urdhërit administrativ nr.170, datë 8.1.1996, duke u paralajmëruar se në rast të kundërt do të veprohej sipas ligjit.

Bashkia e Tiranës, edhe pse në bazë të nenit 177 të Kodit të Procedurës Civile ka si rrugë ligjore ankimin ndaj vendimeve të gjykatës në gjykatën më të lartë, nxjerr urdhër të ri administrativ me nr.1216, datë 26.1.1996, i cili ka të njëjtën përmbajtje me urdhërin e parë.

Gjykata Kushtetuese e gjen antikushtetues urdhërin nr.1216, datë 26.1.1996 të lëshuar në emër të Bashkisë së Tiranës, nga kryetari i saj. Ai vjen në kundërshtim me nenet 3 e 5 të Ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, ku sanksionohen parimet e ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Sipas këtyre parimeve asnjë organ, duke përfshirë edhe organet e

administratës shtetërore, nuk mund të ndërhyjnë në çështjet që janë në kompetencë të gjykatave. Për më tepër me aktin e nxjerrë, Bashkia e Tiranës ka cënuar detyrën kushtetuese që buron nga neni 9 paragrafi i dytë i Ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, sipas të cilit : “Të gjitha organet shtetërore dhe autoritetet e tjera publike janë të detyruara të sigurojnë zbatimin e vendimeve dhe të akteve gjyqësore”.

Shkelja e këtyre dispozitave kushtetuese ka penguar njëkohësisht zhvillimin e një proces të rregullt ligjor, parashikuar si e drejtë themelore nga neni 38 i Ligjit nr.7692, datë 31.03.1993 “Për një shtojcë në Ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, duke shkaktuar zvarritje në përfundimin e çështjes në shqyrtim.

PER KETO ARSYE ;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 të Ligjit Nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin Nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I :

Shfuqizimin e Urdhërit Administrativ Nr.1216, datë 26.1.1996 të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, si antikushtetues.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot në Tiranë, më 26.4.1996

#### MENDIMI I PAKICES

Nuk pajtohem me vendimin që u muar me shumicë votash, sepse i qëndroj pikëpamjes se kërkesa e qytetares Bedrije Dardha, aktualisht nuk përbën objekt shqyrtimi për Gjykatën Kushtetuese.

Përpara disa vjetësh, e lartpërmendura ka marrë me aera nga Ndërmarrja Komunale Banesa Nr.3 Tiranë një bodrum, i cili ka qenë dhe vazhdon të jetë pronë shtetërore, ndonëse pallati që është ngritur mbi të nga shteti, është privatizuar nga banorët e tij.

Sipas marrëveshjes së lidhur midis tyre, kërkesja e ka adoptuar këtë ambient në lokal tregtie dhe ka filluar të ushtrojë aty së bashku me fëmijët e saj, aktivitet privat.

Kohët e fundit, Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Z. Sali Kelmendi ka lëshuar një urdhër administrativ dhe me ndërhyrjen e organeve të policisë e ka vënë atë në zbatim, duke e nxjerrë kërkesën forcërisht nga lokali dhe duke bllokuar derën e tij.

Kundër këtij veprimi ajo ka reaguar menjëherë dhe me padi të rregullt i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Tiranë. Midis të tjerash, ajo ka pretenduar se është zhveshur padrejtësisht nga posedimi dhe në mënyrë të kundërligjshme është penguar në ushtrimin e veprimtarisë së saj tregtare.

Gjykata e rrethit është investuar dhe ka filluar shqyrtimin e çështjes. Mbi kërkesën e saj, ajo ka vendosur paraprakisht si masë për sigurimin e padisë, hapjen e lokalit dhe rivendosjen në posedim të paditëses, vendim të cilin e ka ekzekutuar forcërisht nëpërmjet zyrës së përmbarimit.

Mirëpo, pa prituri përfundimin e gjyqit, kryetari i Bashkisë megjithëse i thirrur si i paditur në këtë çështje, ka nxjerrë urdhërin e dytë, i njëjtë nga përmbajtja me të parin dhe përsëri e ka zbatuar atë në rrugë administrative, duke e zhveshur kërkesën nga posedimi.

Natyrisht që veprime të tilla janë një kundërvënie e hapur e ekzekutivit ndaj pushtetit gjyqësor dhe cënojnë rëndë parimin kushtetues të ndarjes së pushtetit. Megjithatë, ligjshmëria e tyre nuk i nënshtrohet kontrollit konstitucional. Ato bazohen në akte thjeshtë administrative dhe jo në akte me karakter normativ që nxjerrin organet lokale të pushtetit në ushtrim të funksionit të tyre legjislativ.

Për këtë shkak, është gjykata e zakonshme organi i vetëm kompetent për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve që lindin nga nxjerrja ose zbatimi i akteve të administratës shtetërore, sidomos kur këto prekin të drejtat subjektive të personave fizikë ose juridikë, të fituara në bazë të një marrëdhënie juridike civile, siç është në rastin konkret kontrata e qirasë që ka lidhur kërkesja me Ndërmarrjen Komunale Banesa Nr.3 Tiranë.

Përderisa këto urdhëra të kryetarit të Bashkisë së Tiranës nuk caktojnë rregulla të përgjithshme dhe abstrakte, pra nuk janë akte normative, gjykata e zakonshme nuk ka asnjë pengesë ligjore për ta zgjidhur vetë çështjen përfundimisht. Ajo, nuk ka nevojë për ndërhyrjen e Gjykatës Kushtetuese, që kjo t’i shpallë antikushtetuese ose antiligjore këto urdhëra ose veprime të paligjshme të tij dhe duke e mbajtur çështjen të pezulluar të presë përgjigjen e saj. Përkundrazi, ligji i njeh asaj të

drejtën jo vetëm për të rivënë në ekzekutim me anë të zyrës së përmbarimit vendimin që ka marrë për sigurimin e padisë, por edhe për të kërkuar vënien përpara përgjegjësisë penale ose

disiplinore të personave fajtorë, që kanë vepruar në kundërshtim me këtë vendim të saj.

Jo vetëm kaq, por në qoftë se nga shqyrtimi i çështjes në themel do të rezultojë që kërkueses i janë shkelur të drejtat e fituara në bazë të kontratës së qerasë së lidhur për lokalin, Gjykata pa përfillur këto urdhëra administrative, mund të dalë me vendim përfundimtar dhe ta rivendosë atë në këto të drejta.

Prandaj, pa u konsumuar të gjitha fazat dhe shkallët e këtij gjykimi të zakonshëm, as kërkuesja as subjektet e tjerë që përmenden në nenin 24 të Ligjit Nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin Nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, nuk mund ta investojnë Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e kësaj çështje.

A N Ë T A R I

**Zija Vuci**